



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### Procesverbal i mbajtur më 28 korrik 2022, në mbledhjen e VI-të (gjashtë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:20.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Naim Çunaku, Arnisa Sylejmani, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Sebastina Vokri, Bashkim Syla dhe Mrika Thaçi, ndërsa mungoi Qëndrim Softolli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Marigona Lahu Nënkyetare e Komunës, Fatlum Osmani U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, Avni Fetahu U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, Saranda Stublla U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ.

### Rendi i ditës

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje dhe njëkohësisht duke rikujtuar thirrjen dhe materialin e kësaj mbledhje. Konstatoi kuorumin dhe ftoj nëse ka të interesuar për të marrë fjalën sa i përket pikave të rendit të ditës.

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, propozoj shtimin e tri pikave në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje, fjala është për tri projekte në fushën e bujqësisë, dhe atë, “Furnizimi dhe montimi i serrave”, “Furnizimi me mekanizëm bujqësor” dhe “Furnizimi me mëshqerra”, projekte të cilat janë shpallë në bazë të Rregullores së subvencioneve dhe Drejtoria përkatëse kur ka shpallë thirrjen për aplikim, projektet e cekura kanë qenë të parapara me participim prej 70% nga Komuna dhe 30% përfituesi. Në vitet e kaluara Ministria e Financave për çështjen në fjalë nuk ka kërkuar vendime të Kuvendit të Komunës, mirëpo tani janë imponuar që të merren këto vendime në mënyrë që mjetet buxhetore nga participimi i fermerëve përfitues të kalojnë në Kuvendet Komunale, prandaj edhe sot i’u kemi paraqitur propozimet vendimet përkatëse për mjetet buxhetore të cilat duhet të miratohen në Kuvend, dhe ky vendim i Ministrisë së Financave ka ardhë pasi që është dërguar materiali i kësaj mbledhje sipas afateve të rregullta andaj kemi vlerësuar se mund të futen si pika shtesë përmes Komitetit për Politikë dhe Financa.

Po ashtu viteve të ardhshme ne duhet ta bëjmë të njëjtën gjë pasi të lidhen kontratat e prokurimit për arsye se asnjëherë nuk e dimë sakt vlerën e projektit, rrjedhimisht vlerën e sakt të participimit.

Kërkojmë mbështetjen e juaj pasi që bëhet fjalë për projektet e cekura të cilat nuk mund të realizohen pa u miratuar këto propozim vendime të cilat tani veç ju janë shpërndarë.

**znj.Mrika Thaçi**, theksoi, edhe unë kam propozim që rendit të ditës t’i shtohet edhe një pikë shtesë, dhe atë ka të bëjë me gjendjen e furnizimit me ujë, ku sot në këto temperatura shumë të larta, shto këtu edhe

ardhjen e bashkatdhetarëve tanë, furnizimi me ujë është shumë shqetësues, lagje të caktuara me orë të tëra nuk kanë ujë, andaj kërkoj që kjo çështje të hynë si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, i hedhim në votim propozimet e dhëna nga dy parafolësit, dhe atë sipas radhës.

*Në propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, nga 8 anëtarë/e të KPF-së sa ishin prezent në mbledhje, me 6 vota PËR, asnjë votë kundër dhe 2 vota të PËRMBJATURA, mbështetet përfshirja e 3 (tri) pikave shtesë, në kuadër të rendit të ditës, dhe atë:*

*- Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri, për projektin “Furnizimi dhe montimi i serrave”.*

*- Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri, për projektin “Furnizimi me mekanizëm bujqësor”.*

*- Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri, për projektin “Furnizimi me mëshqerra”.*

**znj.Adelinë Stublla**, theksoi, para se të votohet për propozimin e koleges, do të doja një sqarim shtesë rreth kërkesës në fjalë se si mundemi ne të realizojmë diçka të tillë ngase me të vërtetë është një shqetësim për banorët, andaj kërkova sqarim shtesë se çfarë mund të bëjmë ne, para se të votojmë.

**znj.Mrika Thaçi**, theksoi, unë fillimisht propozova të futet si pikë shtesë për diskutim dhe e njëjta të kaloj në Kuvend për marrjen e vendimit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, mendoj se propozimi i znj.Mrika Thaçi është që të diskutohet rreth mënyrës se si të zgjidhet problemi në fjalë.

*Në propozim të anëtares së Kuvendit znj.Mrika Thaçi, njëzëri nga 8 anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në mbledhje, mbështetet përfshirja e pikës shtesë, në kuadër të rendit të ditës, dhe atë:*

*- Diskutim lidhur me furnizimin me ujë të pijes*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani e hedhim në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, si dhe 4 pikat shtesë të rendit të ditës të cilat morën votat e mjaftueshme për tu përfshirë në rend të ditës për këtë mbledhje.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se, njëzëri nga 8 anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në mbledhje, miratohet rendi i propozuar i ditës, përfshirë edhe 4 pikat shtesë, sipas thirrjes dhe materialit përkatës dhe atij të prezantuar në fillim të mbledhjes.*

## **1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura më; 27 prill 2022 dhe 28 qershor 2022**

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri miratohen procesverbalet nga mbledhjet e KPF-së, sipas kësaj pike të rendit të ditës.*

## **2. Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2021**

**- Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Zyrës  
Kombëtare të Auditimit**

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, paraqiti raportin dhe planin në fjalë, ndër të tjera theksoi, është obligim ligjor që raportet e tilla të diskutohen në Kuvendet e Komunave dhe në këtë kontekst ka qenë e planifikuar që të diskutohet në mbledhjen e muajit qershor, mirëpo meqë

raporti në është sjellë pasi që është mbajtur seanca e Kuvendit, e kemi lënë që ky raport të diskutohet në muajin korrik.

Si Ekzekutiv i Komunës e kemi përgatitur edhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe të gjeturave të ka dhënë Zyra Kombëtare e Auditimit, mirëpo më e mira është që raporti është pozitiv, është një raport i pakualifikuar dhe që jemi ndër komunat e pakta që kemi një kualifikim të tillë sepse vetëm 13 komuna kanë një raport të tillë, e që nga Komunat e mëdha ku përfshihemi edhe ne si Komunë e Podujevës vetëm 2 komuna janë me një kualifikim të tillë, mirëpo edhe shumë institucione tjera shtetërore nuk e kanë një raport të tillë, kjo për shkak se Zyra Kombëtare e Auditimit këtë vit ka përdorur kritere shumë më të ashpra për vlerësim, pro megjithatë ne kemi dalë pozitivisht.

Pra kemi 12 të gjetura të cilat kryesisht janë të gjetura teknike, por si do që të jetë edhe për ato të gjetura ne e kemi dërguar edhe planin e veprimit për zbatimin e atyre rekomandimeve në mënyrë që të mos të na përsëriten në raportin për vitin 2022.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, të diskutohet për raportin e Auditorit të jashtëm si një prej instrumenteve më kredibile i cili është i ndërtuar prej Kuvendit të Republikës së Kosovës për monitorimin e pasqyrave të buxhetit për një vit fiskal, sigurisht se është meritë dhe është fjalë e profesionistëve dhe si të tillë sot ne sot në KPF e kemi në rend të ditës që të debatojmë për këtë raport dhe besoj edhe në seancën e Kuvendit.

Për mendimin tim ajo që do të duhej t'i paraprinte këtij raporti, ndoshta nuk bëhet e tepërt t'i lexoj dispozitat përkatëse të Ligjit për vetëqeverisje lokale, konkretisht kompetencat e Komitetit për Politikë dhe Financa në të cilat parashihen që fillimisht ta kemi planin e punës së prokurimit, planin e punës dhe raportin e punës së Kryetarit të Komunës si dhe planin e punës së auditorit të brendshëm, mirëpo shtojta kësaj e që do të ishte e rrugës që ashtu siç e propozoj Nënkryetarja e Komunës në mbledhjen e kaluar që të hyn si pikë shtesë me urgjencë edhe raporti i performancës së Komunës, kurse sot nuk e kemi. Pra dua të them se faza e monitorimit të një buxheti për një vit kalendarik ka 4 filtera, gjegjësisht 4 njësi kompetente që duhet ta monitorojnë, duke filluar në rend të parë nga Kuvendi i Komunës, Auditori i brendshëm, auditori i jashtëm, dhe shtojta kësaj edhe raportin mbi transparencën dhe raportin e performancës si dhe krejt në fund të paraqitet në ueb faqen e Komunës që të jetë publik dhe mundësi për auditim edhe nga qytetarët, pra a i kemi kaluar këto faza ne si Komunë, sigurisht se jo, ashtu sikurse nuk kemi raport të auditorit të brendshëm, pastaj a kemi raport të performancës, jo, dhe të gjitha këto, jo, kanë bërë që për këtë raport ne si anëtar të Kuvendit të mos jemi të përgatitur, gjegjësisht nuk i kemi të gjatë komponentët që do të bënim një vlerësim real për të gjeturat e auditorit të jashtëm.

Një qeverisje e mirë bazohet në këto komponentë, sundimi i ligjit, llogaridhënia, transparenca, zhvillimi social dhe ekonomik të qëndrueshëm dhe investime në projekte që përmirësojnë jetën e qytetarëve, ndërsa në raportin e auditimit për Komunën e Podujevës është e vërtetë ajo që shkruan ashtu siç e ceku edhe drejtori parafolës se kemi një raport të pamodifikuar, dhe më gëzon fakti që për nga përvoja ime politike asnjëherë si Komunë nuk kemi pas raport apo tjetër për Komunën e Podujevës, por e vërteta është se në raportet e auditorit të jashtëm ka pas shumë të gjetura që na kanë bërë që të jemi të vetëkënaqur me kategorizimin e raporteve si të pamodifikuar kurse në anën tjetër me një numër të madh të shkeljeve të qëllimshme apo të paqëllimshme qofshin ato.

Duke mos dashur të elaboroj më shumë ngase nesër e kemi seancën e Kuvendit dhe aty do të japim edhe shpjegime tjera për këtë raport, unë i jap mbështetje këtij raporti për diskutim e që mund të them se nuk është ashtu siç do të donim të jenë të menaxhuara financat e Komunës tonë, ka edhe shumë për të dëshiruar.

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF, kërkon nga parafolësi që të konkretizoj atë që e potencoj.

**z.Naim Çunaku**, vazhdon, është në dorën time ta them konkretisht apo përgjithësisht sepse jamë duke diskutuar unë, mirëpo meqë po kërkon diçka konkrete edhe po e them tani, në raportin përkatës keni edhe vërejtjen e auditorit që pasqyrat vjetore të paraqitura para Kuvendit të Komunës në raportet periodike, nuk

janë të sakta dhe ka devijime nga ajo që është paraqitur para Kuvendit të Komunës, dhe tani nuk dëshiroj të marrë shumë kohë dhe t'ju a lexoj edhe rekomandimet e marra nga auditori i jashtëm, pra vetëm një gjë po e marr shembull, qytetarët e Komunës së Podujevës ku është paraqitur raporti vjetor e ka ditur që nga projektbuxheti fillestar i kemi pasë të shpenzuara nga granti qeveritar 911,000.00€, nga të hyrat vetanake 674,000.00€, nga donatorët 138,000.00€, nga Unioni Evropian dhe disa me vlera minimale e që e tëra ka dal që Komuna e Podujevës ka shpenzuar buxhetin 93%, por buxheti nuk është shpenzuar aty ku prek drejtpërdrejt qytetarin sa i përket investimeve kapitale, kategori për të cilën në bazë të pasqyrave dhe të gjeturave të auditorit del që ne kemi buxhet të shpenzuar vlerën mbi 2,400,000.00€, dhe për këtë unë vetëm një pyetje e kam, e jemi ne që aq shumë i kemi përbush nevojat e qytetarëve që të kemi tepriçë buxhetore shumë prej mbi 2,400,000.00€.

Pastaj përderisa vet auditori i jashtëm thotë në raport disa herë keq menaxhim dhe keq planifikim, unë nuk dëshiroj të zgjerohem më shumë sot mirëpo nesër në Kuvend do të vazhdojmë tutje.

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF, theksoi, raporti i auditorit e thotë që pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës janë të ndërtuara në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe ka një paraqitje të sakt dhe të drejtë të këtyre pasqyrave financiare. Përgjatë fazës së auditimit dhe fazës para auditimit që është një fazë përgatitore që është bërë në fund të vitit 2022 kanë qenë disa lëshime teknike por që të cilat janë përmirësuar në procedurë të rregullt.

Paraqitja është pasqyrë e saktë financiare dhe këtë e thotë raporti i auditorit, por nëse parafolësi ka një raport tjetër atëherë në rregull është, mirëpo zyra e auditorit thotë kështu, janë 12 të gjetura që janë dhënë, e që ne mund t'i diskutojmë secilën prej tyre veç e veç dhe sa i përket pjesës financiare janë edhe arsyeshmëritë edhe tek plani i veprimt, andaj rrjedhimisht është raporti më mirë që ka pasë Komuna ndonjëherë e që këtu nuk ka dilemë fare dhe për këtë mund të bëjmë debat dhe ta diskutojmë, por ajo që është më e mira është se raporti i auditorit është raporti më i mirë që ka ndonjë komunë sot në Republikën e Kosovës.

Për cilat të gjetura po flitet, të thuhet konkretisht dhe unë jua sqaroj secilën, madje edhe me centë, por edhe ju jap arsyen përse ka ndodh e gjetura si dhe përse nuk ka pasë mundësi të ndodh ndryshe.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, pa dashur të hy shumë në detaje sepse jemi duke diskutuar për diçka që nuk kërkon miratimin në Kuvend sepse kështu e përcakton ligji që raporte të tilla të prezantohen para Kuvendit dhe e jona është ta diskutojmë.

Drejtori i'u referua raportit të auditimit dhe në një formë na vuri në pikëpyetje se kujt po i referohem unë, mirëpo i them drejtorit se raportin përkatës të auditimit e posedoj dhe vetëm po referohem faqes 7 të raportit - Zyra Kombëtare e Auditimit, mbi të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit, gjatë auditimit kemi vërejtur fusha për përmirësime të mundshme rreth menaxhimit të financave dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si; mos pajtueshmëri me rregullat tek investimet kapitale, subvencionet dhe transferet, pagesat e ekzekutuara përmes vendimeve të gjykatës, përveç këtyre kemi evidentuar edhe çështje tjera në menaxhimin financiar dhe pajtueshmërisë përfshirë keq klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimit të pasurisë dhe llogaritë e arkëtueshme. Po ashtu procesi i raportimit në Komunë është përcjellë me mangësi (atë që e ceka më herët) dhe kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të cilat kishin edhe gabime tjera të cilat janë vërejtur edhe gjatë auditimit dhe janë bërë korrigjime të mundshme. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim korrigjimin.

Raporti financiar ka rezultuar me 12 rekomandime prej tyre 6 rekomandime të reja.

Unë vetëm po i lexoj të gjeturat e auditorit dhe nuk po dal përtej kësaj, nuk kam gjetur lavde në raport se po të gjeja do t'i lexoja edhe ato, mirëpo nuk ka se si të mos jetë shqetësuese kur mbi 500,000.00€ apo gjysmë milion euro kemi shpenzime për pagesa sipas vendimeve të gjykatës, po shqetësuese që qytetari i Komunës së Podujevës dhe unë si anëtar i Kuvendit dhe duhet ngritur është që për atë afër 300,000.00€ keni paguar shpenzime shtesë, dhe me një buxhet që kemi, të shpenzohen afër 800,000.00€ përmes

pagesave të dhunshme nuk është në rregull, e që për këtë drejtori e di që do të thotë se janë ngarkesa nga Kontrata kolektive e gjëra të ngjashme, mirëpo kur e keni miratuar buxhetin për këtë vit a keni paraparë ato mjete për realizimin e atyre pagave, ne si Grup të kemi thënë që nuk i keni paraparë ato mjetet dhe e njëjta gjë do të na përsëritet edhe vitin e ardhshëm.

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF, theksoi, vërtetë se është shumë shqetësuese çështja e vendimeve gjyqësore dhe ekzekutimi i 500,000.00€ përmes vendimeve të tilla e që kryekëput janë nga Kontrata kolektive që e kanë nënshkruar ato ish partitë tuaja (i drejtohet parafolësit z.Naim Çunakut LDK-PDK) para fushatës zgjedhore për të marrë vota dhe kanë bërë ngarkesë të buxhetit dhe kanë nënshkruar pa mbulueshmëri e që është vepër penale dhe në fakt kanë shkaktuar pasoja për çdo institucion. Sa i përket asaj që parafolësi e ceku se nuk kemi planifikuar buxhet për këtë çështje, nuk e di se si t'i planifikojmë kur nuk kemi limite buxhetore në kategorinë e pagave sepse kemi vetëm mbi 12 milion euro në kategorinë e pagave që është e mbuluar kurse këto mjete në shumë 500,000.00€ nga vendimet gjyqësore është e obliguar Ministria e Financave t'i mbuloj sepse ne nuk kemi asnjë mundësi.

**znj.Adelinë Stublla**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së, këtë pikë të rendit të ditës e rekomandojmë për Kuvend.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, që në fillim unë doja ta zgjeroj debatin dhe këtë e potencova se nuk dëshiroj ta zgjeroj debatin për këtë çështje sepse do ta diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit, mirëpo veprimet e drejtorit të DBF, e në veçanti fjalie tij kur e thotë duke mu referuar mua, partitë e tuaja LDK-PDK, e kanë nënshkruar Kontratën Kolektive, kjo është e pa tolerueshme. Së pari nga drejtori duhet të bëhen dallimi mes institucionit dhe partive politike sepse nuk është duke e bërë dhe kjo po ndodh shpesh sepse nuk kanë nënshkruar partitë politike PDK-LDK, por institucionet e Republikës së Kosovës ku kanë qenë si rezultat i votës së qytetarëve ashtu siç jeni ju sot duke menaxhuar Komunën si rezultat i votës së qytetarëve.

**znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës**, theksoi, vetëm desha të ndërlihem me atë që u cek rreth raportit të performancës dhe raportit të auditorit të brendshëm për të cilat e kam thënë para juve se do t'i diskutojmë për shkak se janë përgjegjësi që unë jam marrë to dhe kur e them se do t'i diskutojmë zakonisht edhe e mbaj fjalën. Sa i përket raportit të performancës, nuk e kemi sjellë për shkak se ende jemi në dilema se raportimi është dashtë të kryhet para 30 qershorit apo nëse ka ndonjë afat shtesë deri më 30 shtator dhe për këtë jemi duke pritur një përgjigje nga Ministria e Pushtetit Lokal, andaj në rast se Ministria e thotë që pikët nuk merren parasysh nga raportimi i raportit të performancës dhe nuk vlerësohet kjo pas datës 30 qershor atëherë është një mundësi e djegur që realisht është djegur nga Grupi i LVV-së dhe Grupi i LDK-së që nuk e kanë votuar, por në rast se Ministria e thotë që pikët merren parasysh edhe nëse diskutimi dhe raportimi për raportin e performancës bëhet edhe pas datës 30 qershor ne do ta sjellim për diskutim në Kuvend. Pavarësisht a do të merret parasysh apo jo nga Ministria, ne në mbledhjen e muajit shtator do ta sjellim për diskutim raportin e performancës dhe krahas kësaj do të jetë edhe raporti i auditorit të brendshëm për të cilin kam diskutuar me auditorin e brendshëm dhe për shkak të specifikave që ka auditimi i brendshëm, auditori është duke u përpjekur të përshtatë raportin e auditimit të brendshëm i cili përfshinë vetëm çështjet brenda Komunës dhe me qëllim që të raporti të mos ketë shkelje të dispozitave, kështu që këto dy raporte do të diskutohen.

Për hir të korrektësisë, sa i përket Raportit financiar gjithmonë ka qenë i pamodifikuar, por për vitin 2022 ka qenë i modifikuar.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, më bën të ndihme mirë që raporti i performancës ka hyrë në agjendën e sjelljes në Kuvend për diskutim dhe qëllimi i vetëm i raportit të performancës është që t'ju jap mundësi pushteteve lokale ta bëjnë një garë për mirëqeverisje, dhe krejt me qëllimin më të mirë që do të doja edhe Komuna ime, pavarësisht kush e udhëheqë, të merr donacion që do të ishin të mirëseardhura për buxhetin e Komunës dhe për lehtësimin e jetës së qytetarëve.

Me gjithë respektin për Nënkryetaren e Komunës, nuk jam shumë i ngarkuar politikisht kur hyjë në mbledhje, por në mbledhjen e kaluar të KPF-së ishte si informacion por poenta ime ishte që të kemi një pasqyrë reale në mënyrë që të debatojmë profesionalisht për raportin financiar, ngase ne nuk jemi profesional në këtë aspekt, dhe kam thënë se do të duhej t'i kemi raportin e performancës, raportin e auditorit të brendshëm i cili i paraprinë raportit të auditorit të jashtëm, transparenca dhe llogaridhënia janë elemente bazë të një qeverisje, kështu që për qytetarët dhe për Komunën po shpresoj se ne do të renditemi me ato Komuna që do të kenë përfitime nga mirë qeverisje që do të ndodh.

Falënderoj Nënkryetaren për informatën për raportin financiar të vitit 2020 i cili paska qenë i modifikuar, sepse kam menduar se asnjëherë nuk ka qenë një i tillë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën unë hedh në votim që ky kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

*Njëzëri nga 8 anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendi të Komunës i rekomandohet për diskutim.*

### **3. Raporti Financiar janar - qershor 2022**

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, duke e paraqitur raportin në fjalë, theksoi, është obligim ligjor që të paraqiten para Kuvendit të gjitha shpenzimet nëpër kategori të caktuara buxhetore për këtë periudhë gjashtëmujore të vitit me qëllim të diskutimit në Kuvendin e Komunës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, rreth këtij raporti gjashtëmujor kam vetëm një shqetësim që dua të ngris, fjala është tek menaxhimi i buxhetit gjegjësisht tek investimet kapitale ku në bazë të këtij raporti kemi të shpenzuara vetëm 1 milion e 14 mijë euro, dhe po ta marrim me përqindje del shumë ulët dhe tani po kalon muaji i gjashtë i vitit. Jam në dijeni se në muajt e par të vitit nuk mund të punohet për arsye të stinës dhe të tjera, por me shqetësimin tim dhe pritjet që të mos përsëritet sërish që të mbetet buxhet i pashpenzuar për investime kapitale, të ketë kujdese shtesë rreth menaxhimit dhe realizmit të projekteve të miratuara në Kuvend në mënyrë që të mos ndodh të mbetet buxhet i pashpenzuar përderisa ka mundësi. Nga ajo që na paraqitet në këtë raport më bën të krijoj dilema që të mos ndodh të mbetet sërish buxhet i pashpenzuar, ndërsa për detaje dhe specifika tjera rreth këtij raporti do të diskutoj nesër në mbledhjen e Kuvendit ngase ka disa elemente në kundërshtim me menaxhimin e drejtë të financave e që më bëjnë të jap mendimin tim dhe këtë do të jap në mbledhjen e Kuvendit.

**z.Florent Hasani**, theksoi, Grupi i LVV e rekomandon këtë pikë të rendit të ditës për diskutim në mbledhjen e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

*Njëzëri nga 8 anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendi të Komunës i rekomandohet për diskutim.*

### **4. Propozim vendimi për caktimin e normave të tatimit në pronë për vitin 2023**

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti propozim vendimin në fjalë, theksoi, ky propozim është sjellë në bazë të Ligjit për tatimin në pronë në bazë të të cilit përcaktohen edhe normat tatimore duke respektuar limitet e normave. Vlen të ceket se me këtë propozim normat e tatimit në pronë janë caktuar në limite minimale dhe nuk mund të ulim më shumë se sa që

përcaktohet me Ligj, andaj kërkoj që ky propozim vendim t'i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendi të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

*Njëzëri nga 8 anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendi të Komunës i rekomandohet për shqyrtim.*

## **5. Propozim Rregullorja për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës**

**znj.Saranda Stublla**, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, modeli i kësaj propozim Rregulloreje është i njëjti me modelin unik të përgatitur nga Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Ky propozim ka kaluar procedurat e diskutimit publik e që sigurisht keni mundur t'i shikoni edhe raportet nga diskutimet publike që janë mbajtur. Dokumenti është i përgatitur në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, Ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës dhe Rregullores përkatëse, prandaj edhe i propozohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të kësaj Rregulloreje.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendi të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

*Njëzëri nga 8 anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendi të Komunës i rekomandohet për shqyrtim.*

## **6. Propozimet për zëvendësimin e 2 (dy) anëtarëve të Komitetit për Komunitete (pas dhënies së dorëheqjes nga dy ish anëtar/e të Komitetit nga radhët e Komuniteteve jo shumicë)**

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, lidhur me këtë ju informoj se dy anëtarë kanë dhënë dorëheqje nga ky Komitet, bëhet fjalë për dy anëtar nga radhët e komunitetit jo shumicë. Pra ashtu siç keni mund t'i shikoni edhe në materialet e dërguara, ish anëtarja znj.Albina Avdiu nga komuniteti ashkali ka dhënë dorëheqje për shkak të punësimit në një institucion informativ-RTK, kurse është sjellë propozimi nga komuniteti i njëjti që ajo të zëvendësohet me znj.Naile Ahmeti.

Pastaj kemi dorëheqjen e z.Muhamet Sadiku nga komuniteti rom, ndërsa po ashtu është sjellë propozimi që i njëjti të zëvendësohet nga z.Selver Rama nga po i njëjti komunitet.

Andaj nëse nuk dëshiron ndokush fjalën unë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendi të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

*Nga 8 anëtarë/e të KPF-ës sa ishin prezent në mbledhje, me 6 vota PËR, asnjë votë kundër dhe 2 vota të PËRMBJATURA, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim, përkatësisht zëvendësimin e këtyre dy anëtarëve në kuadër të Komitetit për Komunitete .*

## 7. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022

**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit, e paraqiti informatën në fjalë, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, para vetës keni Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022, e cila është më gjeneral dhe e përgjithësuar për arsye të kërkesave të juaja që keni pasë me planin e punës, andaj edhe kam bërë përpjekje t'i përfshijë të gjitha dhe kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të rekomandohet për mbledhjen e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

*Njëzëri nga 8 anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendi të Komunës i rekomandohet për diskutim.*

## 8. Propozim vendimet për shtim të buxhetit dhe kode të ri, për projektet

8.1. "Furnizimi dhe montimi i serrave".

8.2. "Furnizimi me mekanizëm bujqësor".

8.3. "Furnizimi me mëshqerra"

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, tani kemi edhe pikat e rendit të ditës të cilat në fillim të mbledhjes hyrën si pika shpesh në kuadër të rendit të ditës, andaj për sqarime shpesh edhe njëherë fjalën ja jap drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, paraqiti propozim vendimet në fjalë, theksoi, kemi të bëjmë me tri projekte të ndara të miratuara me buxhetin e vitit 2022 dhe rrjedhimisht bëhet fjalë për tri vendime të ndryshme të cilat janë obligim ligjor, andaj edhe mendoj se më praktikë do të ishte të shkohet me tri pika të ndara në kuadër të rendit të ditës.

Sa i përket sqarimeve, konsideroj se të gjitha i potencova në fillim të mbledhjes kur edhe i prezantova këto tri propozim vendime.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa jam në dijeni unë kemi edhe një projekt për furnizim me Bletë, i cili po ashtu është me participim, andaj meqë po bëhet fjalë për projekt të ngjashëm, përse nuk është sjellë propozim vendimi edhe për atë projekt të që kalohen të gjitha dhe të mos merremi më me diçka të ngjashme.

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF, përgjigje Kryesuesit të Kuvendit, theksoi, e vërtetë që është edhe ai projekt mirëpo ende nuk është lidh kontrata dhe nuk i ka kaluar procedurat e prokurimit, andaj pa qenë ne sakt në dijeni për vlerën e projektit nuk mund ta sjellim një propozim vendim të tillë sepse nëse projekti është në vlerë 100,000.00€ ne duhet ta sjellim propozimin për 30,000.00€ apo siç është 30% të vlerës së participimit.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, kërkoj një sqarim nga drejtori parafolës pasi që ai e potencoj se për çdo projekt të tillë tani e tutja duhet të miratohet edhe vendim në Kuvendin e Komunës, prandaj kërkoj ta di se a mund të rregullohet kjo çështje me ndonjë kod buxhetor të veçantë, apo pas çdo subvencionit duhet të shqyrtojmë propozim vendime të tilla.

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF, sqarim parafolësit, theksoi, pas çdo subvencionit duhet të miratohet vendim i tillë në mënyrë që të mundësohet realizimi i atij projekti. Pra realisht kemi të bëjmë me bartjen e mjeteve buxhetore nga realizimi i participimit me vlerë të sakt financiare. Pra ne gjithëherë kemi vlerë të përafërt të mjeteve financiare për projekte, por ashtu siç sjellën ofertat përmes procedurës së prokurimit ne nuk mund ta dimë sakt. Vendimi duhet të jetë sakt i precizuar sa i përket vlerës financiare, kështu që pa u



lidh kontrata me operatorin ekonomik përfitues dhe pa u bërë pagesa prej 30% të projektit nga përfituesit e subvencionit ne nuk mund të sjellim propozim vendim të tillë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, sa i përket këtyre propozim vendimeve është diçka e re dhe po ashtu na u prezantuan si pika shtesë në fillim të kësaj mbledhje dhe rrjedhimisht nuk patëm se si ta përpunojmë si materie, andaj edhe vota jonë (Grupi i LDK-së) ishte abstenim ngase vendimet e Kuvendit të Komunës gjegjësisht të KPF-së nuk mund të shkojnë pas projekteve, por ato duhet t'iu paraprijnë, andaj edhe ky ishte hezitim i joni deri sa të na sqarohet, mirëpo jemi për, që propozim vendimet në fjalë të rekomandohen për shqyrtim në seancën e Kuvendit.

Sa i përket se si të renditen këto pika, konsideroj se meqë janë tri propozim vendime të ndryshme dhe për tri projekte të ndryshme duhet të jenë pika të ndara veç e veç.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendi të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, dhe atë si tri pika të ndara veç e veç.

*Pas votimit, njëzëri i rekomandohen Kuvendit të Komunës për shqyrtim të tri (3) propozim vendimeve sipas materialeve përkatëse të prezantuara në hyrje të kësaj mbledhje, si dhe me rekomandim që propozimet vendimet të ndahen në pika të veçanta, dhe atë 7, 8 dhe 9.*

## **11. Diskutim lidhur me furnizimin me ujë të pijes**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, po ashtu kemi të bëjmë me këtë pikë e cila hyri si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje dhe për të njëjtën pothuajse në hyrje e sqaroj nevojën për diskutim propozuesja znj.Mrika Thaçi, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim të kësaj pike apo teme nëse mund ta quajmë ashtu.

*Njëzëri nga 8 anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në mbledhje, i rekomandohet Kuvendi të Komunës për diskutim.*

*Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 11:05**

**Procesverbalin e mbajti  
Enis Sheholli**

**Nr.prot.01-060/04-0062320/22  
Podujevë,  
28 korrik 2022**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit  
Hilmi Hoxha**